

Npi – 01/185 datë: 26.04.2023

Duke u bazuar në nenin 51.2 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, Nr. 03/L-040; Nenit 36 dhe 37.4 të Statutit të Komunës së Shtimes, 01Nr.06/1636 të datës 03.09.2008; Si dhe në bazë të nenit 3.8 dhe 3.13 të Rregullores të Punës së Kuvendit dhe Komiteteve Npi – 01/114 datë: 26.04.2019, Komiteti për Ambient, Shërbime Publike dhe Urbanizëm, për mbledhjen e mbajtur më: 26.04.2023, nxjerr këtë:

E K S T R A K T
PROCESVERBAL

IMBLEDHJES -II- TË KOMITETIT PËR AMBNIENT, SHËRBIME PUBLIKE DHE URBANIZËM E mbajtur më datën: 26.04.2023 (e mërkurë) në ora 14.00h.
në sallën e vogël të Kuvendit

Në mbledhje kanë marrë pjesë, Kryesuesi i Komitetit: z.Adem Ramadani, Anëtarët: z.Rahman Jakupi, z.Muhamet Ademaj, z.Fetah Dugolli dhe z.Nexhat Neziraj. Përveç anëtarëve të Komitetit në mbledhje kanë marrë pjesë edhe: z.Kastriot Shabani, drejtor i DZHE-së, z.Reshat Gashi, zyrtar për të drejtat e njeriut dhe barazi gjinore.

Mbledhjen e hapi Kryesuesi i Komitetit z.Adem Ramadani, i cili pasi përshëndeti të gjithë të pranishmit, Konstatoi Kuorumin e mjaftueshëm për të vazhduar me mbledhjen e Komitetit. Për këtë mbledhje është propozuar ky:

REND DITE

1. Shqyrtimi i Ekstrakt Procesverbalit nga mbledhja e KASHPU me 27.02.2023,
2. **Informatë nga DSHP mbi menaxhimin e mbeturinave, (shtyhet)**
3. **Informatë nga DSHP mbi mirëmbajtjen e parqeve dhe hapësirave publike, (shtyhet)**
4. **Informatë mbi raportin e performancës së Komunës, (shtyhet)**
5. **Informatë mbi gjendjen me furnizim me ujë të pijes, (shtyhet)**
6. Informatë nga sektori i bujqësisë për përgatitjen e të mbjellave pranverore.

Kryesuesi, z.Adem Ramadani; Hapi diskutimin për rendin e ditës.

z.Muhamet Ademaj; Përshëndetje, pajtohem me rendin e ditës. Mirë ka qenë që me qenë edhe drejtorat tjerë prezent në mbledhje sepse disa nuk qenkan këtu.

*** Komitetit për Ambient, Shërbime Publike dhe Urbanizëm, unanimisht miratoi rendin e ditës.**

Pika 1

Shqyrtimi i Ekstrakt Procesverbalit nga mbledhja e KASHPU me 27.02.2023

Kryesuesi, z.Adem Ramadani; Hapi diskutimin për këtë pikë.

*** Komitetit për Ambient, Shërbime Publike dhe Urbanizëm, unanimisht miratoi Procesverbalin nga mbledhja e KASHPU-së më 21.12.2022.**

Pika 2

Informatë nga DSHP mbi menaxhimin e mbeturinave

Kryesuesi, z.Adem Ramadani; Meqenëse për pikat 2 dhe 3 nuk është prezent drejtori, unë propozoj për me i shty këto dy pika, a ka diskutime, nëse nuk ka kush është për me i shty këto dy pika.

*** Komitetit për Ambient, Shërbime Publike dhe Urbanizëm, unanimitisht vendosi për me i shty pikat 2 dhe 3.**

Pika 3

Informatë mbi raportin e performancës së Komunës

Kryesuesi, z.Adem Ramadani; Hapi diskutimin për këtë pikë.

z.Rrahman Jakupi; Përshëndetje, unë propozoj që me i shty pikat që nuk janë prezent drejtorët. Kastrioti qenka prezent është shembull i mirë.

*** Komitetit për Ambient, Shërbime Publike dhe Urbanizëm, unanimitisht vendosi me e shty këtë pikë.**

Pika 4

Informatë mbi gjendjen me furnizim me ujë të pijes

Kryesuesi, z.Adem Ramadani; Hapi diskutimin për këtë pikë, meqenëse diskutime nuk ka, a jeni që edhe këtë pikë me e shty.

*** Komitetit për Ambient, Shërbime Publike dhe Urbanizëm, unanimitisht vendosi me e shty këtë pikë.**

Pika 5

Informatë nga sektori i bujqësisë për përgatitjen e të mbjellave pranverore

Kryesuesi, z.Adem Ramadani; Fjalën për prezantimin e kësaj pike ja dha z.Kastriot Shabani.

z.Kastriot Shabani, drejtor i DZHE; Përshëndetje, unë e kam përgatitur informatën në formë të shkruar, dhe e keni pranuar me ftesën për mbledhje. Unë do ta lexoj informatën në pikat kryesore, e pastaj nëse ka ndonjë pyetje unë do të përgjigjem. (Shih dokumentin)

z.Rrahman Jakupi; Faleminderit për Informatën. Unë kam një pyetje që ka të bëjë me Qenët endacak, se a mos kemi ndonjë shifër të tyre se sa janë në komunën tonë? Dhe sa është shuma totale e projektit?

z.Kastriot Shabani, drejtor i DZHE; Kontrata ka qenë e nënshkruar me 5900€. Ligji për qenët Endacak është në leximin e dytë, dhe pa miratimit të Ligjit me Qenët endacak ka me u marrë niveli qendror.

Kryesuesi, z.Adem Ramadani; E di që ka filluar procedura e trajtimit të Qeneve endacak, a ka ndonjë afat që Qeveria ka me ndërmarrë diçka, për me u eliminuar ky problem?

z.Kastriot Shabani, drejtor i DZHE; Ky është problemi më i madh lidhur me trajtimin e Qeneve endacak, përpara i kanë vlarë, por tani është e ndaluar rreptësishtë. Psh. Komuna e Suharekës nuk ndanë mjete financiare fare nga Buxheti për këtë qëllim dmth. për trajtimin e qeneve endacak. Për këtë arsye është problem me e trajtuar si duhet këtë problem vetëm Komuna, sepse ata lëvizin nga një rajon në tjetrin dhe shtohen.

Kryesuesi, z.Adem Ramadani; A ka pas dëmtime bujqësore sivjet?

z.Kastriot Shabani, drejtor i DZHE; Duhet ta sqaroj mirë këtë çështje, ne si Komunë nuk kemi fond të ndarë për mbulimin e dëmtimeve eventuale bujqësore. Ne e bëjmë vetëm vlerësimin e dëmit, e pastaj të dhënat dërgohen në Ministrinë e linjës. Tani këtu nuk i kam të dhënat por unë mundem me ua dërgua me E-mail nëse dëshironi.

z.Muhamet Ademaj; Sa i përket projektit për ndarjen e serave, është mirë që janë ndarë mjete për këtë destinim, sa e di kanë përfituar 98 persona. Te Qenët endacak, është mirë me mujt e me zgjidhë këtë problem, mirëpo ne si Komunë e vogël, nuk kemi mundësi pa ndihmën e nivelit qendror. Po shpresojmë se pas aprovimit të Ligjit, niveli qendror do ta bëjë një zgjidhje.


z.Kastriot Shabani, drejtor i DZHE; Dje e kemi biseduar këtë çështje, kemi pas dy ankesa, por ky Besart Mujota, nuk ka aplikuar, dhe rrjedhimisht nuk mundet me përfitua askush pa aplikuar.

z.Nexhat Neziraj; Përshëndetje, kam një pyetje, se kur ka me filluar shpërndarja e farës?

z.Kastriot Shabani, drejtor i DZHE; Ne kemi filluar mjaft herët, mirëpo e kemi një ankesë në OSHB, mirëpo nëse deri të premtën nuk vjen vendimi, ne kemi me filluar ndarjen e mjeteve në llogaritë e tyre bankare.

Kryesuesi, z.Adem Ramadani; Pasi që diskutime të tjera nuk kishte Kryesuesi mbledhjen e përfundoi në ora 14:34h

Procesmbajtësi:
Idajet Rexhepi



Kryesuesi i Komitetit
Adem Ramadani

